



AKT-THEMELIMI

I SHOQERISE TREGTARE " CLASSIC " SH P K

1. Agron PAPULI, i biri i Sotirit, lindur me Tirane ne 07.12.1955 dhe banues ne Lagjen Nr. 2, Rr. "Kengyel i Lushit" Pall. 30 Shk. --- Ap. --- Tirane, me pasporte Nr. --- *Lepos vj. noster,*

2. Artan QESKO, i biri i Harallambit, lindur me Tirane ne 01.07.1959 dhe banues ne Lagjen Nr. 2, Rr. "Qemal Stafa"; Pall. 3; Shk. 1; Ap.6; me pasaporte AZ Nr.086450

- Te lartepemendurit kane rene dakort qe te krijojne nje **SHOQERI TREGTARE me PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**, konform vullnetit te tyre te lire si dhe ne baze te Ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 "PER SHOQERITE TREGTARE" dhe Ligjit Nr. 7667 date 28.01.1993 "PER RREGJISTRIN TREGTAR" si dhe Ligjit Nr.7512 date 10.08.1991 "PER SANKSIONIMIN DHE MBROJTJEN E PRONES PRIVATE E NISMES SE LIRE,VEPRIMTARISE PRIVATE DHE PRIVATIZIMIT" si me poshte:

Neni 1

Te themelojne nje SHOQERI TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR per te ushtruar veprimtari ekonomike e private te emertuar: " **Classic " Sh p k**.


Kjo Shoqeri Tregtare do te kete seline e saj ne Rrethin e Tiranës, ne Rr. e Kavajes (ish Ndermarrja "Mihal Duri".

Periudha e veprimtarise se Shoqerise do te jete nga momenti i marrjes se Lejes per ushtrimin e aktivitetit 20 vjet.

Neni 2

Sipas legjislacionit Shqiptar, **SHOQERIA TREGTARE " CLASSIC " SHPK** eshte person juridik shqiptar dhe aktivitetin e saj e rregullon ne baze te Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 dhe Ligjit Nr.7667 date 28.01.1993 nga normat e parashikuara ne kete Akt -Themelimi dhe Statutit qe do t'i bashkengjitet ketij te fundit.

Shoqeria Tregtare ne marredheniet me te tretet pergjigjet vetem me pasurite e shoqerise: Ajo, shoqeria, nuk pergjigjet per detyrimet qe marrin ortaket si persona fizik, tej veprimtarise se shoqerise apo tej kapitalit te saj.



Prezeshu **ORTAKET** nuk pergjigjen per detyrimet e kesaj Shoqerie, ne raport me pjeset e Kapitalit Themeltar ne kete Shoqeri.

Neni 3

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE TREGTARE " CLASSIC " Sh p k do te jete:

- NGRITJA E NJE AKTIVITETI TREGETAR DHE RIPARUES PER PERFAQESIMIN EKSKLUZIV TE FIRMES "VOLKSWAGEN A.G." NE SHQIPERI. KJO DO TE ARRIHET:

- 1. NDERMJET SHITJES ME SHUMICE DHE PAKICE: TE PJESEVE TE KEMBIMIT, NYJEVE, AGREGATEVE DHE AUTOMJETEVE TE TE GJITHA LLOJEVE TE MARKAVE: "VOLKSWAGEN", "AUDI", "SEAT" DHE "SKODA"**
- 2. NDERMJET ORGANIZIMIT TE SHERBIMIT TE SERVISIT UNIVERSAL PER TE GJITHA LLOJET E AUTOMJETEVE**

REALIZIMI I KETIJ QELLIMI DO TE KERKOJE:

- ORGANIZIMIN E NJE RRJETI NJESISH TREGETARE DHE RIPARUESE QE DO TE VEPROJNE KONFORM DESTINACIONIT KRYESOR, NE EMER DHE PER LLOGARI TE " CLASSIC " SH.P.K.**
- ORGANIZIMIN E PANAIREVE DHE EKSPOZITAVE PER PARAQITJEN E AUTOMJETEVE TE KETYRE MARKAVE, TE PUBLICITETIT TREGETAR SI EDHE RUAJTJEN E EKSKLUZIVITETIT TREGETAR NE TERRITORIN E REPUBLIKES SE SHQIPERISE, NE BASHKEPUNIM TE NGUSHTE DHE KONFORM KERKESAVE TE GRUPIT "VOLKSWAGEN"**

Neni 4

Shoqeria ne baze te legjislacionit shqiptar ka te drejte te hapi filiale, dege, perfaqesi dhe te jape perfaqesimin ne te gjithë teritorin e Republikes se Shqiperise si dhe jashte saj ne perputhje me legjislacionin e vendeve ku ato do te hapen.

Neni 5

Veprimtaria e Shoqerise, emertimi, objekti dhe selia e saj, si edhe Kapitali Themeltar i percaktuar ne kete Akt-Themelimi, nuk mund te ndryshojne pa vendimin e te dy ortakeve.

2



KAPITALI THEMELTAR i Shoqerise eshte 100 000 leke dhe ky kapital u takon teresisht te dy Ortakeve, te cilet e kane ndare ne 100 kuota, ku cdo kuote eshte e barabarte me 1 000 leke.

Pjesemarrja dhe kontributi i Ortakeve ne kete Kapital Themeltar eshte:

1. Agron PAPULI **2/3 e kapitalit**

3. Artan QESKO **1/3 e kapitalit.**

Po mbi raportin e pjesemarrjes se mesiperme ne Kapitalin Themeltar, do te ndahet edhe fitimi i realizuar nga Shoqeria me veprimtarine e saj.

- **Keto kuota dhe mjetete Kapitalit Themar te Shqerise, shenohen ne Librin e Llogarise se Shoqerise. Ato jane te shlyeshme dhe te nenshkrueshme dhe depozitohen ne nje nga Bankat e Shqiperise.**
- **Ne Librin e Llogarise se Shoqerise, krijohet edhe 'Fondi Themelor i Ortakeve'. Ortaket nuk kufizohen ne rritjen e kontributit te tyre ne Kapitalin Themelor te Shoqerise.**

Neni 7

Ortaket perbejne ASAMBLENE E ORTAKEVE, qe eshte pronare e te gjitha pjeseve te Kapitalit Themeltar

ORTAKET angazhohen qe pas marrjes se Lejeve perkatese per ushtrimin e aktivitet nga Organet Shteterore Kompetente, Kapitallet ne natyre do te rriten ne menyre te konsiderueshme.

Neni 8

Kapitali themeltar i Shoqerise, sipas nenit 4 te kesaj kontrate perfageson kapitalin e derdhur dhe ate qe parashikohet te derdhet per te ardhmen nga ORTAKET, te nevojshem per veprimtarine e Shoqerise. Sipas kerkeses se Ligjes Kapitali Themeltar do te depozitohet ne nje nga Bankat e Shtetit Shqiptar ose ne nje nga Bankat e tjera qe jane hapur ose do te hapen ne te ardhmen ne Shqiperi, te njohura nga Shteti Shqiptar. Kapitali Themeltar mund te jete i shprehur edhe ne natyre vleresimi i te cilit do te jete sipas legjislacionit te dale per kete qellim.

Ne librin e llogarise qe do te krijohet ne shoqerine tregtare do te shenohet kapitali i derdhur nga ORTAKET. Rritja e kapitalit nuk eshte e kufizuar.

3



Shoqeria e pushon aktivitetin e saj me mbarimin e afatit të përcaktuar në këtë kontratë ose për shkak të perligjura që gjykohen të tilla nga **ASAMBLEJA E ORTAKEVE**.

Fitimi i realizuar nga veprimtaria ekonomike e shoqërisë pas shlyerjes së detyrimeve ligjore dhe ato që kanë lindur me të tretet, mbetet prone e **ORTAKEVE** dhe perdoret sipas interesave të tyre.

Neni 10

ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE JANE:

- **ASAMBLEJA E ORTAKEVE**
- **ADMINISTRATORI I PERGJITHSHEM.**
- **KOMISIONI I REVIZIONIMIT DHE I EKSPERTEVE KONTABEL**

Administratori emërohet e shkarkohet prej Mbledhjes së **ASAMBLESE SE ORTAKEVE**. Modalitetet për përberjen dhe funksionimin e organeve të mesipërme përcaktohen nga statuti i Shoqërisë si dhe nga Ligji Për Shoqëritë Tregtare.

Neni 11

Punonjësit që do të punësohen në Shoqëri janë të detyruar të ruajnë sekretin e dokumentacionit informacionit, njohjeve dhe të eksperiencës së këmbës dhe të realizuar brenda Shoqërisë dhe të marrin të gjitha masat për të evituar përhapjen e tyre qoftë dhe në mënyrë të pjesëshme.

ORTAKET dhe Administratori janë përgjegjës për pasojat e demshme, të shkeljeve ndaj ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Neni 12

VLEFSHMERIA E KONTRATES:

Kjo kontratë është e vlefshme për një periudhë 20 vjeçare. **ASAMBLEJA E ORTAKEVE** ka të drejtë që kur ta shikojë të arsyeshëm të vendosë për zgjatjen ose mbylljen e aktivitetit të Shoqërisë, konform legjislacionit dhe Ligjit "Për Shoqëritë Tregtare"

Neni 13

Zgjidhja e mosmarreveshjeve midis **ORTAKEVE** dhe të treteve do të bëhet konform normave të konventave ndërkombëtare për rregullimin e mosmarreveshjeve në Shoqëritë Tregtare, në Gjykatën e Rrethit Tiranë.



Dispozitat me te detajuara per Shoqerine Tregtare “ CLASSIC ” sh p k jane percaktuar dhe permbahen ne Statutin e saj.

Neni 15

Kjo kontrate formulohet ne kater kopje, nga te cilat nje depozitohet ne Zyren e Noterise Tirane, nje depozitohet ne Gjykaten e Rrethit Tirane, nje ne Zyren e Tatimeve Tirane dhe kopja e katert mbahet ne dokumentat e Shoqerise.

Kontrata eshte e vlefshme qe nga momenti i nenshkrimit te saj nga **ORTAKET**.

ORTAKET

1. Agron PAPULI,

2. Artan QESKO.

(Artan Qesko)



STATUT I SHOQERISE TREGTARE " CLASSIC " SH P K

Shoqeria Tregtare me pergjegjesi te kufizuar " CLASSIC " shpk, eshte krijuar sipas Aktit te Themelimit te saj nga ortaket: Z. Agron PAPULI dhe Z. Artan QESKO te dy me kombesi dhe nenshtetesi shqiptare .

Per te bere te mundur veprimtarine ekonomike dhe organizimin e kesaj Shoqerie ne perputhje me Ligjin Nr.7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare"dhe Ligjit Nr.7667 date 28.01.1993 "Per rregjistrin Tregtar", eshte perpiluar ky Statut me kerkesat e Ligjes per Shoqerite Tregtare me pergjegjesi te kufizuar si me poshte:

KREU I PARE

DISPOZITA TE PERGJITHSHME (forma, emertimi, objekti, selia, kohezgjatja)

Neni 1

Ortaket e lartepemendur pjesemarres ne Aktin e Themelimit, kane krijuar nje Shoqeri Tregtare me pergjegjesi te kufizuar.

Shoqeria Tregtare fiton personalitetin e saj juridik me rregjistrimin e saj ne **GJYKATEN E RRETHIT TIRANE** si dhe regjistrimin e saj ne **REGJISTRIN TREGTAR**.

Neni 2

EMERTIMI I SHOQERISE TREGTARE eshte "CLASSIC" SHPK dhe ka si objekt te saj:

- NGRITJEN E NJE AKTIVITETI TREGETAR DHE RIPARUES PER PERFAQESIMIN EKSKLUZIV TE FIRMES "VOLKSWAGEN A.G." NE SHQIPERI. KJO DO TE ARRIHET:

- 1. NDERMJET SHITJES ME SHUMICE DHE PAKICE: TE PJESEVE TE KEMBIMIT, NYJEVE, AGREGATEVE DHE AUTOMJETEVE TE TE GJITHA LLOJEVE TE MARKAVE: "VOLKSWAGEN", "AUDI", "SEAT" DHE "SKODA"**
- 2. NDERMJET ORGANIZIMIT TE SHERBIMIT TE SERVISIT UNIVERSAL PER TE GJITHA LLOJET E AUTOMJETEVE**



REALIZIMI I KETIJ QELLIMI DO TE KERKOJE:

- **ORGANIZIMIN E NJE RRJETI NJESISH TREGETARE DHE RIPARUESE QE DO TE VEPROJNE KONFORM DESTINACIONIT Kryesor, ne emer dhe per llogari te “ CLASSIC “ SH.P.K.**
- **ORGANIZIMIN E PANAIREVE DHE EKSPOZITAVE PER PARAQITJEN E AUTOMJETEVE TE KETYRE MARKAVE, TE PUBLIÇITETIT TREGETAR SI EDHE RUAJTJEN E EKSKLUZIVITETIT TREGETAR NE TERRITORIN E REPUBLIKES SE SHQIPERISE, NE BASHKEPUNIM TE NGUShte DHE KONFORM KERKESAVE TE GRUPIT “VOLKSWAGEN”**

Neni 2/2

Shoqeria mund te ushtroje gjithshu dhe aktivitete te tjera ndihmese, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, te konsideruara me perfitim dhe te dobishme per arritjen e objektivave te saj kryesore.

Neni 3

SELIA E SHOQERISE TREGTARE eshte ne Tirane, ne Rr.e Kavajes (ish Ndermarrja “Mihal Duri”.

Neni 3/2

Shoqeria ne baze te legjislacionit shqiptar ka te drejte te hapi filiale, dege, perfaqesi dhe te jape perfaqesimin ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise si dhe jashte saj ne perputhje me legjislacionin e vendeve ku ato do te hapen.

Neni 3/3

Ndryshimi i selise dhe hapja e filialeve apo zyrave te perfaqesimit, te shoqerise, vendoset nga Ortaket, ne mbledhjen e Asamblese se Ortakeve.

Neni 4

KOHEZGJATJA E SHOQERISE TREGTARE eshte parashikuar per nje periudhe 20 vjecare me te drejte ripërtëritje.

KY AFAT MUND TE ZGJATET OSE TE ZVOGELOHET SIPAS PROPOZIMEVE TE BERA NGA ORTAKET DHE PASI TE VENDOSET NGA ASAMBLEJA E ORTAKEVE.



Neni 5

KAPITALI THEMELOR I SHOQERISE TREGTARE është 100 000 leke dhe është i percaktuar sipas nenit 4 te aktit te themelimit.

Kapitali themeltar është i ndare ne 100 pjese me nje vlefte per sejcilen pjese 1000 leke, te renditura sipas numrit te serise nga 1 deri ne 100 krejtesisht te shlyeshme e te nenshkrueshme.

Shoqeria mund te zmadhoje ose te zvogeloje kapitalin e saj, por po qe kjo e fundit, ortakët duhet te marrin masa per ndryshimin e formes se Shoqerise.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet Ortakeve, ne rruge trashegimie. Ato jane lirisht te transferueshme edhe ne rast ndarje pasurore mes bashkeshorteve.

Pjeset e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne Shoqeri, vetem me miratimin e shumices se Ortakeve qe perfaqesojne te pahten $\frac{3}{4}$ e pjeseve te kapitalit themeltar.

Projekti i transferimit i njoftohet Shoqerise dhe sejcilit prej Ortakeve.

Ne rast se Shoqeria nuk ka bere te ditur vendimin e saj brenda tre muajve nga data e njoftimit te fundit sipas paragrafit te mesiperm, miratimi i transferimit konsiderohet i dhene.

Ne rast se Shoqeria refuzon te jape miratimin e transferimit, Ortaket brenda tre muajve nga data e ketij refuzimi duhet te blejne ose te lejojne blerjen e pjeseve te kapitalit themeltar me vleren e percaktuar.

Kur ka mosmarreveshje per vleresimin e ketij kapitali themeltar, vleresimi i ketyre te drejtave behet nga nje ekspert. Eksperti caktohet nga palet. Kur palet nuk merren vesh ndermjet tyre, ai caktohet nga Gjykata me procedure urgjente.

Transferimi i pjeseve te kapitalit Themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet Ortakeve, ne rruge trashigimie, ne rast ndarje te pasurive ndermjet bashkeshorteve, ndermjet te paralindurve dhe te paslindurve.

Llogaritja e pjeseve te kapitalit themeltar per cdo ortak do te llogaritet ne baze te derdhjes dhe shlyerjes se kuotave te percaktuara, te cilat do te jene te rregjistruara ne librin e llogarise qe do te hapet per kete qellim.

Secili nga Ortaket ka te drejte te largohet me deshiren e tij, por me kusht qe te njoftoje, me shkrim, Asamblene e ORTAKEVE, 3(tre) muaj perpara. Ne kete rast, ai ka te drejte te terheqi pjesen e tij te fitimit sipas kapitalit te tij fillestar, por pasi te jete vertetuar likujdimi nga ana e tij e te gjitha detyrimeve qe ka ndaj paleve te tjera dhe Shoqerise, deri ne momentin e paraqitjes se kerkeses per largim, perfshire ketu edhe shlyerjen e kesteve te kredise. Ai ka te drejte dhe te shesi aksionet e tij, por gjithmone pasi te marri aprovimin e Shoqerise.



Ortakut pergjigjet me pasurine e tij vetjake per detyrimet e Shoqerise. Ne rast se asaj i vjen nje dem efektiv per shkak te personelit te saj, atehere ai do te pergjigjet sipas Legjislacionit penal dhe civil shqiptar per shlyerjen e ketij demi.

KREU I DYTE

ORGANET E SHOQERISE

Neni 6

Keto organe jane:

- Asambleja e Ortakeve
- Administratoret ose Administratori (aktualisht Z. Artan QESKO)
- Komisioni i eksperteve kontabel dhe i revizionimit

Neni 7

Organi vendimor i Shoqerise eshte Asambleja e Ortakeve. Secili Ortak ka te drejte te marre pjese ne mbledhjet dhe vendimet e Asamblese. Çdo Ortak ka te drejte vote te barabarte. Ne ushtrimin e se drejtes se tyre, per te mare pjese ne vendimet kolektive, çdo Ortak ka te drejte te perfaqesohet nepermjet personave te tjere te autorizuar prej tyre dhe te pajisur me prokure.

Asmbleja e Ortakeve vendos per bilancin vjetor, per ndryshimet ne statut, per shtimin dhe paksimin e kapitalit themeltar, per emerime e shkarkime te administratorit, per emerimin e eksperteve kontabel, per pushimin, per hapjen e degeve, perfaqesive dhe filialeve ne rrethet e tjera, per transformimin e shoqerise ne nje forme tjeter, per zgjatjen e afatit etj.

Mbledhja e Asamblese se Ortakeve thirret nga nje ose disa Ortake qe zoterojne mbi 1/10 e pjeseve te Kapitalit Themeltar, nga Administratori, nga ekspertet kontabel te autorizuar ose nga likujduesit. Sipas rendesise se vendimeve mbledhjet e asamblese mund te jene te zakonshme ose te jashtezakonshme:

Asambleja e zakonshme, me shumice absolute votash vendos per ceshtje te tilla si emertime ose shkarkime per administratoret, eksperteve kontabel te autorizuar dhe likujduesve, miratimi i raporteve te administrimit dhe kontrollit, miratimi i llogarive vjetore dhe ndarjes se fitimit etj.

Asambleja e jashtezakonshme vendos per ceshtje te tilla si ndryshimi i statutit, zvogelimi i kapitalit themeltar, transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar tek te tretet, zgjatja e kohes se veprimtarise se Shoqerise apo likujdimi i saj, shndrimi i Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ne nje shoqeri te formave te tjera. Keto vendosen nga Ortaket qe perfaqesohen ne menyre te barabarte sipas pjeseve te kapitalit themeltar.



Asambleja e zakonshme ne mbledhjen e pare mund te marre vendime te vlefshme ne qofte se jane te pranishem ose te perfaqesuar ne numer ortakesh qe zoterojne mbi 3/4 e pjeseve te kapitalit themeltar dhe vendimet merren me shumice votash te 3/4 te ortakeve te pranishem ose te perfaqesuar. Ne qoftese mbledhja e pare e asamblese se zakonshme nuk realizohet, thirret mbledhja e dyte e cila mund te marre vendime te vlefshme, duke lajmeruar 15 dite perpara me shkrim.

Neni 8

Vendimet e marra nga Asambleja e Ortakeve ne mbledhjet e zakonshme e te jashtezakonshme, ne perputhje me kete Statut, jane te detyrueshme e te zbatueshme per sejcilin Ortak.

ASAMBLEJA E ORTAKEVE mbledhjet e zakonshme i ben cdo vit brenda kater muajve nga mbyllja e veprimtarive ekonomike te Shoqerise.

Neni 9

Shoqeria drejtohet nga **ADMINISTRATORI** edhe per problemet ekonomiko - financiare dhe per problemet e shfrytezimit, perpunimit dhe te gjetjes se tregut.

Ne marredheniet me te tretet, shoqeria perfaqesohet nga Administratori i Pergjithshem, i cili i ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet ne interes te Shoqerise dhe ne emer te saj, si edhe cdo aktivitet qe perputhet me objektin e Shoqerise. Ai ka te drejte te perfaqesoje Shoqerine ne marredheniet me personat juridike e fizike si dhe ne te gjitha organet e administrates se shtetit.

Administratorit i jepet e drejta te paraqese vete ne keto organe kerkesa dhe ankesa. Po keto kompetenca ka Administratori dhe ne organet gjyqesore te te gjitha shkalleve. Ai vete, ose duke caktuar avokat, bazuar dhe ne vendimet e Asamblese se Ortakeve, ka te drejte te paraqese me shkrim, ne organet e drejtesise, kerkesa dhe ankesa ne te gjitha shkallet e gjykimit.

Administratori ne menyre individuale nuk ka te drejte te kryejne veprimet e meposhteme:

- 1- Te realizoje kontrata shitje dhe blerje per pasurite e patundeshme te shoqerise.
- 2- Te lidhe kontrata qiraje me te tretet.
- 3- Te lidhe kontrata shitje dhe blerje, te terheqe nga llogarite qe mund te kete Shoqeria neper banka jo me shume se vlera 80,000.00 (tetedhjete mije) USD ose ekuivalentin e kesaj shume te konvertuar ne monedhe tjeter. Per keto raste veprimesh deri ne shumen e percaktuar me larte kerkohet vetem nenshkrimi i tij.
- 4- Te lidhe kontrata huaje ne cfaredo shume me banka ose me cilindo person te trete si dhe te hipotekoje prona te palujtshme ose te luejteshme te Shoqerise, pa miratimin e Asamblese se Ortakeve.
- 5- Te punesoje personel te perhershem me kontrata pune mbi nje vjeçare.



Administratori emerohet dhe shkarkohet me miratimin nga Asambleja e Ortakeve dhe kete funksion duhet t'a kryeje patjeter njeri prej Ortakeve, qe zoteron shkallen e duhur te kualifikimit ne kete drejtim.

Kur administratori, konstatohet se vepron ne kundërshtim me interesat e Shoqerise, atehere nje grup Ortakesh, kane te drejten qe te paraqesin me shkrim, perpara ASAMBLESE, kerkesen per shkarkimin e tij.

Ne kete kerkese per shkarkim duhet te jene paraqitur me fakte se ku Administratori ka vepruar ne kundërshtim me interesat e Shoqerise.

Administratori ose administratorët, ne rast se do te kete, shkarkohen me vendim te ortakeve, qe perfaqesojne me teper se $\frac{3}{4}$ e pjeses se kapitalit themeltar

ASAMBLEJA e ORTAKEVE duhet te pergjigjet brenda 30 (tridhjet) diteve nga data e marrjes se lajmerimit.

Ne rast se brenda 30 (tridhjet) diteve nuk pergjigjen ose pergjigjia eshte negative, atehere Ortaket qe kane bere kerkesen per shkarkimin e Administratorit kane te drejte t'i drejtohen Gjykates se Rrethit Tirane, e cila do te vendose.

Mbledhja e Asamblese se Ortakeve cakton detyrat dhe kompetencat per administratorin.

Neni 10

Kontrolli ekonomiko-financiar i Shoqerise kryhet nga nje ekspert kontabel i autorizuar, i emeruar per çdo vit financiar me mundesi rizgjedhje. Ai caktohet nga mbledhja e Asambleja e Ortakeve me shumice votash.

Neni 11

Per punonjesit qe do te punesohen ne Shoqerine Tregtare do te zbatohen aktet ligjore dhe nenligjore te dale per kete qellim duke lidhur kontratat e punes me sejcilin per nje afat jo me shume se 1 (nje) vjeçar.

Paga e punes nuk eshte e kufizuar por ajo nuk mund te jete me e ulet se ajo e percaktuar me vendime te vecanta te Qeverise.

Çdo person i punesuar ne shoqeri eshte personalisht pergjegjes per kryerjen e detyres. Ai eshte i detyruar te ruaje karakterin e fshehte te dokumentacionit, te permbushe te gjitha detyrimet qe do te rrjedhin nga kontrata e punes, vendimet e marra nga Shoqeria, si edhe te zbatoje Statutin e Shoqerise.



KREU I TRETE

MARREDHENIET EKONOMIKO FINANCIARE

Neni 12

Viti financiar fillon me daten 1 Janar dhe mbaron me daten 31 Dhjetor te cdo viti, perjashtim behet vetem per vitin e pare qe mbaron me 31 dhjetor 1999.

Me mbylljen e tij, perfundojne: llogarite vjetore, inventari, raportet dhe operacionet e vitit financiar dhe raportet e vecanta te hartuara nga administratoret dhe eventualisht nga eksperti kontabel.

Miratimi i bilanceve dhe i dokumentacionit mbi veprimtarine vjetore behet nga Asambleja e Ortakeve, brenda muajit Mars te vitit pasardhes.

Neni 13

Pas miratimit te llogarive vjetore, perballimit te detyrimeve, taksave, tatimeve, shpenzimeve te ndryshme, detyrimet ndaj te treteve dhe evidentimit te ekzistences se fitimit neto, **ASAMBLEJA E ORTAKEVE** percakton pjesen qe i takon mbi fitimin, te cilit i jane zbritur shumat e lena menjane per fondin rezerve te domosdoshem (jo me pak se 1/20 e fitimit te cdo viti, deri sa ky fond te arrije vleren e 1/10 te kapitalit themeltar) si dhe te jene zbritur ose te jene shtuar respektivisht humbjet e mbartura apo fitimet e mbartura nga vitet e meparshme.

Ndarja e fitimit neto do te behet ne proporcion me pjesen e sejcit Ortak ne kapitalin Themeltar, pas mbylljes se cdo bilanci 3(tre) mujor.

Neni 14

Llogarite ekonomike dhe ato kontabel mbahen ne Shqiperi ne gjuhen shqipe sipas legjislacionit te miratuar, ne leke ose ne valute te huaj.

Veprimtaria ekonomike mbahet ne baze te akteve ligjore dhe nenligjore te dala per kete qellim dhe mbeshtetet ne aktivin dhe pasivin qe detyrimisht do te pasqyrohen ne bilancet e perpiluara nga ekspertet kontabel te autorizuar te cilet mbajne pergjegjesi ligjore per punen e tyre.

Neni 15

Shoqeria Tregtare me qellim qe te beje sa me te lehte dhe me te shpejte pagesat me te tretet do te hape nje llogari bankare ne nje nga Bankat qe jane te njohura nga Shteti Shqiptar vendase ose te huaja.



KREU I KATERT

ZGJATJA E AFATIT, PRISHJA, LIKUJDIMI

Neni 16

Me mbarimin e afatit te percaktuar ne kontraten e themelimit zgjatja e tij behet vetem me vendimin e ASAMBLESE se ORTAKEVE.

Shoqeria likuidohet kur mbaron afati i percaktuar dhe Ortaket nuk kane rene dakort qe te bejne ripерteritjen e ketij afati.

Ajo likuidohet edhe me vendimin e mbledhjes se Asamblese se Ortakeve, ne rast se Shoqeria nuk rezulton me fitim, per shkak te forcave madhore ose per shkaqe te tjera ligjore

Shoqeria mund te shndrohet ne nje nga format e percaktuara nga ligji dhe ne formen e kerkuar nga ligji.

Neni 17

Shoqeria Tregtare hyn ne procesin e likujdimit qe ne momentin e vendosjes per prishjen e saj. Per fillimin e ketij procesi Asambleja e Ortakeve emerone ose disa likujdues, i cili paraqet raportin e likujdimit, gjendjen e aktivitetit te pasivitetit te Shoqerise, mbi menyren e ndjekjes se operacionit te likujdimit dhe afatin e nevojshmem per perfundimin e tyre.

Ne fund te procesit te likujdimit, Asambleja e Ortakeve, vendos mbi bilancin perfundimtar, mbi aktin dhe rregullsine e likujdimit, mbi mbylljen e procesit te likujdimit te Shoqerise.

Mbas pagimit te kreditorëve dhe shlyrjes se pjeseve te Kapitalit Themeltar tek kontribuesit perkates, likujdatori ose gjykata vendos per pjeset e mbetura midis Ortakeve, proporcionalisht me pjeset qe ata zoterojne ne kapitalin Themeltar.

Neni 18

Te gjitha mosmarreshjet qe do te lindin ndermjet Ortakeve ose ne marredheniet me te tretet, gjate ekzekutimit te ketij statuti dhe kontrates se themelimit gjate ekzistences se Shoqerise si dhe gjate kryerjes se veprimtarise ashtu dhe ne procesin e likujdimit do ti drejtohen per gjykim Gjykates se Rrethit Tirane.



Neni 19

Ky **STATUT** është hartuar në katër kopje, njëra kopje depozitohet në Zyrën e Noterisë, njëra në Gjykatën e Rrethit Tiranë, njëra në zyrën e tatimeve dhe kopja e fundit mbahet në dokumentat e krijimit të Shoqërisë.

ORTAKET

1. Agron PAPULI,

2. Artan QESKO

(Artan Qesko)